



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 7, Datë 29.12.2016

PËR

MIRATIMIN E NISMËS PËR HARTIMIN E PLANIT TË DETAJUAR PËR ZONËN E RËNDËSISË KOMBËTARE TË VALBONËS

Në mbështetje të neneve 7, 10, 18 dhe 25 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 671, datë 29.07.2015 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të VKM-së Nr. 881, datë 14.12.2016 “Për miratimin Planit të Përgjithshëm Kombëtar të Territorit” si dhe Vendimit Nr. 1097, datë 28.12.2015 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:


1. Miratimin e Nismës për hartimin e Planit të Detajuar për Zonën e Rëndësisë Kombëtare të Valbonës (PDZRK-së Valbonë).
2. Dokumenti i plotë i Nismës për hartimin e PDZRK-së Valbonë përmban:
 - a. analizën, e cila përcakton qëllimin dhe nevojën për hartim ose rishqyrtim të planit të detajuar;
 - b. kufijtë e zonës së rëndësisë kombëtare sipas dokumentave të planifikimit kombëtar;
 - c. planin e veprimeve për hartimin e dokumentit të PDZRK-së;
 - d. listën e dokumenteve përbërës të PDZRK-së;
 - e. fushat e ekspertizës që do të përbëjnë grupin e punës që do të hartojnë PDZRK-në;
3. Fillimin e procedurës për ngritjen e grupit të punës me ekspertë me qëllim hartimin e Planit të Detajuar për Zonën e Rëndësisë Kombëtare të Valbonës.
4. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit të drejtojnë punën për hartimin e PDZRK-së Valbonë dhe të kryejnë bashkërendimin, këshillimin dhe

organizimin e dëgjësive publike me të gjitha autoritetet e planifikimit dhe palët e interesuara.

5. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për zbatimin e këtij Vendimi.
6. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



ZËVENDËS KRYETAR I KKT

EGLANTINA GJERMENTI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN



MILVA EKONOMI

MINISTËR I ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES



SEKRETAR I KKT

LEDIA TOTA

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

